



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

RREGULLORE (QRK) Nr. 22/2024 PËR EKSPERTËT¹

¹ Rregullore (QRK) nr. 22/2024 për Ekspertët, është aprovuar në mbledhjen e 216-të, të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 07/216, datë 14.08,2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

në mbështetje të nenit 93, paragrafin 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 44, paragrafin 2 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe nenin 8, paragrafin 4, nën-paragrafin 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe dhe në pajtim me nenin 78, paragrafin 6, nënparagrafin 6.2 të Rregullores (QRK)- Nr. 17/2024 së Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) NR. 22/2024 PËR EKSPERTËT

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për zbatimin e shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për kategorinë e ekspertëve, ashtu siç përcaktohen në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike** – nënkupton sistemet që plotësojnë së paku njërin nga kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore;

1.2. **pronar i një sistemi të rrjetit dhe informacionit** - nënkupton institucionin që i plotëson të gjitha kriteret e mëposhtme:

1.2.1. e ka zhvilluar vetë apo përmes palëve të treta sistemin shtetëror të informacionit dhe komunikimit;

1.2.2. ka blerë apo është pronar i licencës për operim të sistemit shtetëror të informacionit dhe komunikimit;

1.2.3. ka përgjegjësi ligjore për zhvillimin ose sigurimin e funksionimit të atij sistemi shtetëror të informacionit dhe komunikimit.

1.3. **menaxhim i një sistemi të rrjetit dhe informacionit** - nënkupton përgjegjësinë për sigurimin e buxhetit dhe resurseve të tjera të nevojshme për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit shtetëror të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike;

1.4. **administrim i një sistemi të rrjetit dhe informacionit** - nënkupton përgjegjësinë për konfigurimin dhe mirëmbajtjen e tij, monitorimin dhe optimizimin e performancës së tij, menaxhimin e të dhënave, kopjeve rezervë dhe rikthimit të të dhënave të sistemit, sigurinë e sistemit të rrjetit dhe informacionit, menaxhimin e infrastrukturës së atij sistemi të rrjetit dhe informacionit dhe detyra të tjera që ndërlidhen me funksionimin teknik të atij sistemi;

1.5. **koordinim për një sistem të rrjetit dhe informacionit** - nënkupton përgjegjësinë për koordinimin e politikave, dizajnimin dhe funksionalizimin e sistemit të rrjetit dhe informacionit në nivel qendror;

1.6. **komision** – nënkupton Komisionin për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike;

1.7. **ZKA** – nënkupton Zyrtarin Kryesor Administrativ të institucionit sipas legjislacionit në fuqi;

1.8. **ligji** – nënkupton Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptim të njëjtë siç janë përdorur në Ligjin përkatës për Pagat në Sektorin Publik, Ligjin përkatës për Zyrtarët Publik, si dhe legjislacionin relevant në fuqi.

KAPITULLI I PROCEDURA PËR PËRCAKTIMIN E SISTEMEVE SHTETËRORE TË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT ME RËNDËSI STRATEGJIKE

Neni 4

Kriteret për vlerësimin e sistemeve

1. Sistemet do të vlerësohen si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, nëse plotësojnë të paktën një prej kriterëve të mëposhtme:

1.1. përbëjnë infrastrukturë kritike të informacionit që përfshin sistemet ose funksionet, paaftësimi ose shkatërrimi i të cilave do të mund të cenonte sigurinë kombëtare, qeverisjen, ekonominë ose mirëqenien sociale të vendit;

1.2. janë të natyrës së tillë që mundësojnë realizimin e funksioneve themelore shtetërore si në vijim:

1.2.1. regjistrimi civil dhe ai i automjeteve;

- 1.2.2. tatimet;
- 1.2.3. dogana;
- 1.2.4. buxheti dhe financat, përfshirë thesarin;
- 1.2.5. prokurimi publik;
- 1.2.6. shëndetësia;
- 1.2.7. pensionet dhe mirëqenia sociale;
- 1.2.8. edukimi dhe arsimi;
- 1.2.9. siguria, rendi dhe ligji;
- 1.2.10. drejtësia;
- 1.2.11. siguria kibernetike, siguria e rrjetit qeveritar, të dhënave dhe të qasjes në sisteme kompjuterike qeveritare;
- 1.2.12. mbrojtja;
- 1.2.13. zgjedhjet;
- 1.2.14. vizat;
- 1.2.15. regjistrimi i bizneseve;
- 1.2.16. regjistrimi i OJQ-ve;
- 1.2.17. regjistrimi i adresave dhe kadastrit;
- 1.2.18. informacioni gjeografik;
- 1.2.19. monitorimin e kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, monitorim të spektrit dhe për menaxhimin e resurseve frekuencore;

1.3. sistemet lidhen me menaxhimin e proceseve në administratën publike, konkretisht menaxhimin e burimeve njerëzore, postës elektronike zyrtare shtetërore, menaxhimin e pasurisë shtetërore dhe menaxhimin e arkivimit elektronik të dokumenteve;

1.4. sistemet shërbejnë për funksionet qendrore të qeverisjes elektronike;

1.5. qendrat shtetërore të të dhënave;

1.6. rrjetet shtetërore të të dhënave;

1.7. sistemet e rrjetit dhe informacionit që kategorizohen si të klasifikuara bazuar në Ligjin për Klasifikim të Dokumenteve;

1.8. përbëjnë sisteme dhe funksione qendrore kyçe në procesin e digjitalizimit që zhvillohet nga Zyra e Kryeministrit.

Neni 5

Kërkresa për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike

1. Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit i cili vlerëson se institucioni është pronar, menaxhon dhe administron sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, ose koordinon funksionimin e këtyre sistemeve, parashtron kërkesë për vlerësim të sistemit tek Komisioni.

2. Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të përmbajë:

2.1. informacionin për nivelin e klasifikimit të sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit;

2.2. kategorinë e shërbimeve që ofron sistemi përkatës, të cilat mund të jenë si vijon:

2.2.1. përshkrimin e të dhënave që përmban sistemi përkatës;

2.2.2. ndikimin e sistemit përkatës të rrjetit dhe informacionit në realizimin e objektivave të institucioneve shtetërore;

2.2.3. ndikimin e sistemit përkatës të rrjetit dhe informacionit në realizimin e obligimeve ligjore të institucionit kërkues dhe institucioneve të tjera shtetërore;

2.2.4. ndikimin e sistemit përkatës të rrjetit dhe informacionit në realizimin e shërbimeve esenciale.

2.3. vlerësimin lidhur me rrezikimin e sistemit nga sulmet e mundshme kibernetike;

2.4. funksionet menaxhuese/koordinuese dhe shkallën e njohurive të specializuara që kërkohen për menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit;

2.5. sa është unik në nivel shtetëror secili sistem përkatës i rrjetit dhe informacionit, dhe a ofrohen shërbime të ngjashme edhe nga sisteme të tjera të rrjetit dhe informacionit nga institucione tjera shtetërore;

2.6. dëshmitë se institucioni që parashtron kërkesën është pronar, ka në menaxhim dhe administron sistemin e informacionit dhe komunikimit;

- 2.7. pozitave të punës që dëshmojnë se institucioni ka përgjegjësi dhe administron me sistemin e informacionit dhe komunikimit;
- 2.8. emërtimin e pozitave kyçe që janë përgjegjëse për dizajnimin, menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit përkatës të informacionit dhe komunikimit, dhe propozimin për kategorizim të tyre sipas klasave të përcaktuara në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik;
3. Institucioni i cili ka përgjegjësi për zhvillimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të sigurisë kibernetike dhe/apo TIK-ut në nivel shtetëror, duhet që në kërkesë të paraqesë edhe:
- 3.1. bazën ligjore që përcakton përgjegjësitë e institucionit për zhvillimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të sigurisë kibernetike dhe/apo TIK-ut në nivel shtetëror;
- 3.2. pozitave që kanë përgjegjësi zhvillimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të sigurisë kibernetike dhe TIK-ut në nivel shtetëror.
4. Kërkesa sipas këtij neni, bëhet përmes plotësimit të formularit për identifikimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, i bashkëngjitur si Shtojcë 1 e kësaj Rregulloreje. Në rast se institucioni posedon më shumë se një (1) sistem, formulari duhet të plotësohet veçmas për secilin sistem.

Neni 6 Komisioni

1. Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike, themelon Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike.
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, njëri nga të cilët caktohet kryesues, dhe janë përfaqësues të institucioneve si në vijim:
- 2.1. një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike;
- 2.2. një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Financa;
- 2.3. një (1) përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit.
3. Anëtarët e Komisionit emërohen me mandat tre (3) vjeçar.
4. Punën e Komisionit e udhëheq Kryesuesi i Komisionit.
5. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit, kur atyre iu kërkohet nga kryesuesi dhe të kryejnë punën me përgjegjësi dhe objektivitet.

Neni 7

Përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni shqyrton dhe vlerëson kërkesat e dërguara nga Zyrarët Kryesor Administrativ të Institucioneve sipas kësaj Rregulloreje.
2. Në rastet kur Komisioni vlerëson se kërkesa plotëson kriteret e kësaj Rregulloreje për tu cilësuar si sisteme shtetërore me rëndësi strategjike, përgatitë listën e sistemeve të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore, si dhe listën e pozitave të punës të lidhura me sistemet përkatëse, dhe i rekomandon Qeverisë aprovimin e saj.
3. Lista e sistemeve dhe e pozitave që rekomandohet nga Komisioni sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet të përmbajë minimalisht të dhënat si në vijim:
 - 3.1. sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit që përcaktohen si sisteme me rëndësi strategjike;
 - 3.2. institucionet që kanë në pronësi, menaxhojnë dhe administrojnë apo koordinojnë sistemin përkatës shtetëror të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike;
 - 3.3. pozitat e punës në kuadër të sistemeve të përcaktuara në nënparagrafin 3.1. të këtij neni, që janë përgjegjëse për dizajnimin, menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin apo mirëmbajtjen e sistemit përkatës të informacionit dhe komunikimit të kategorizuara sipas klasave të përcaktuara në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.
4. Kur Komisioni vlerëson se kërkesa nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore, i paraqet Qeverisë rekomandim të arsyetuar për mospërfshirjen e sistemit të rrjetit dhe informacionit në listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, si dhe mospërfshirjen në listën e pozitave të punës. Kundër vendimit të Qeverisë mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente.
5. Komisioni është kompetent për trajtimin e kërkesave të reja dhe kërkesave për rishqyrtim nga institucionet, sistemet e të cilave nuk janë përcaktuar si sisteme të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike. Komisioni gjithashtu është kompetent të rishqyrtojë edhe kërkesat e institucioneve për pozitat e refuzuara në kuadër të sistemeve të përcaktuara si sisteme të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike. Kërkesat për rishqyrtim duhet të përmbajnë dëshmi të reja për plotësimin e kriterëve të kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI II

PROCEDURA PËR PËRCAKTIMIN E EKSPERTËVE PËR POZITAT E TJERA TË PËRCAKTUARA NË SHTOJCËN 14.4. TË LIGJIT TË PAGAVE

Neni 8

Procedura e përcaktimit të ekspertëve

1. Zyrtaari Kryesor Administrativ i institucionit në kuadër të të cilit funksionojnë pozitat e

përcaktuara në shtojcën 14.4. të ligjit, parashtron kërkesë për përcaktim të zyrtarëve si ekspertë në përputhje me këtë shtojcë.

2. Kërkesa parashtrohet tek Komisioni për Ekspertët i themeluar me vendim nga Qeveria, pas propozimit nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike.

3. Komisioni për Ekspertët sipas paragrafit 2 të këtij neni, përbëhet nga tre anëtarë si në vijim:

3.1. dy (2) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike;

3.2. një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Financa;

4. Anëtarët e Komisionit për Ekspertët emërohen me mandat tre (3) vjeçar.

5. Punën e Komisionit për Ekspertët e udhëheq Kryesuesi i Komisionit për Ekspertët.

Neni 9 **Përgjegjësitë e Komisionit për Ekspertët**

1. Komisioni për Ekspertët shqyrton dhe vlerëson kërkesat e dërguara nga Zyrarët Kryesor Administrativ të Institucioneve sipas kësaj Rregulloreje.

2. Komisioni për Ekspertët përgatit listën e pozitave të cilët kategorizohen si ekspertë në bazë të shtojcës 14.4 të ligjit dhe i rekomandon Qeverisë aprovimin e saj.

Neni 10 **Dispozitat kalimtare**

Lista e sistemeve dhe pozitave të miratuara para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, mbetet e vlefshme përderisa vazhdon të plotësojë kriteret e kësaj Rregulloreje.

Neni 11 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja (QRK) Nr. 11/2023 për Ekspertët.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

27 gusht 2024